

Nr. 3571 Prot
D. 16.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 3571 prot.

Gjirokastrë, më 14.04.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË
Libohovë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 14, datë 31.3.2026, "Për mbajtjen hapur të kopshtit Nepravishtë", në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore." Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
2. Vendim nr. 16, datë 31.3.2026, "Për miratim kërkesë për miratim marrëveshje tip", konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 618 prot

Libohovë më 02.04.2026

VENDIM

Nr. 12 datë, 31.03.2026

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR
FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.**

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike” , në udhëzimin nr.5, datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”, VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 “Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, propozojmë Këshillit Bashkiak për muajin Shkurt 2026 familjet që do të përfitojnë nga fondi 6%.

VENDOSI

I.Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i 6%, për familjet e mëposhtme,për muajin Shkurt 2026

| Nr | Emri Atesia Mbiemri | Muaji | Shuma/lek |
|----|---------------------|-------------|-----------|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | Shkurt 2026 | 2178 |

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndiemes Ekonomike.

III.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Rahim Skënderi



KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Pro : 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë ,më 11.03.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr 3 datë, 11/03/2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kritereve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike” , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”,VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2025 “Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, propozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin shkurt 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

| Nr | Emri Atesia Mbiemri | Muaji | Shuma/lek |
|----|---------------------|-------------|-----------|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | shkurt 2026 | 2178 |

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndiemes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Sektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika



Juristi
Kristaq Ciko



Prefektura Gjirokaster
Bashkia Libohove,Libohove

LISTË

"LISTA E FAMILJEVE/INDIVIDËVE NË NEVOJË TË REKOMANDUAR PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% PËR PERIUdhËN Shkurt/2026

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Njësinë Administrative Libohove,Libohove rekomandon listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë për trajtim me fondin 6%.

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë se:

-Janë rekomanduar për trajtim me fondin 6% 1 familje, lista bashkëlidhur.

Prefektura Gjirokaster
Bashkia Libohove,Libohove
Personi përgjegjës për ndihmën ekonomike
Emri, Mbiemri firma
MAJLINDA GJIKA

Lista e plotë e familjeve të rekomanduara për trajtim me fondin 6% për periudhën e akorduar.

| Nr. | Emri Atësia Mbiemri | Fondi 6%(Vlera) | Kompensimi i Energjisë(Vlera) | Statusi |
|-----|---------------------|-----------------|-------------------------------|---------------------------------------|
| 1 | Ferdi Sejfulla Ruli | 2178.00 | - | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 618 prot

Libohovë më 02.04.2026

VENDIM

Nr. 13 Datë 31.03.2026

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË
BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS
EKONOMIKE.**

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016, në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH", VKB Libohovë, nr.03 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë, familjet në nevojë që kanë dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, ose që nuk mund të aplikojnë, të përfitojnë nga fondet e vete Bashkisë.

VENDOSI

I.Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga Bashkia, për familjet e mëposhtme, për muajin Shkurt 2026

| | Emer, mbiemer | Arsyet | LEKE |
|---|------------------|------------------------------------|------|
| 1 | Josif Proko | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 2 | Marika Mino | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 3 | Vilson Buzo | Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur | 5000 |
| 4 | Ferdi Ruli | Person i vetëm, I paaftë për punë | 3000 |
| 5 | Gjergji Ruli | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 6 | Fredi Proko | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 7 | Rusho Maçi | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 8 | Enkeleda Matushi | Prind i vetëm me fëmijë të mitur | 5000 |

| | | | |
|----|--------------------|------------------------------------|------|
| 9 | Madrit Avduli | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 10 | Zenel Çobani | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 11 | Resul Sinani | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 12 | Shqiponjë Myftaraj | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 13 | Afërdita Mërtiri | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 14 | Rigels Ruli | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |
| 15 | Niko Karavidha | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 16 | Gani Ruçi | Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur | 5000 |

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndhimes Ekonomike.

III.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi




KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



Miratuar me 14 (katërbëdhjetë) vota

Vota Pro : 14 (katërbëdhjetë) vota

Vota Kundër : asnjë

Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot.

Libohovë më 11.03.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 02 datë 11/03/2026

PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH", VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, ose që nuk mund të aplikojnë, të perfitojne nga fondet e vetë Bashkisë .

Propozojmë Këshillit Bashkiak.

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga bashkia familjet e mëposhtme,për muajin shkurt 2026.

| | Emer,mbiemer | Arsyet | LEKE |
|---|--------------|------------------------------------|------|
| 1 | Josif Proko | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 2 | Marika Mino | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 3 | Vilson Buzo | Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur | 5000 |
| 4 | Ferdi Ruli | Person i vetëm ,I paaftë për punë | 3000 |
| 5 | Gjergji Ruli | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 6 | Fredi Proko | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 7 | Rusho Maçi | Person i paaftë për punë | 5000 |

| | | | |
|----|--------------------|------------------------------------|------|
| 8 | Enkeleda Matushi | Prind i vetëm me fëmijë të mitur | 5000 |
| 9 | Madrit Avduli | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 10 | Zenel Çobani | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 11 | Reşul Sinani | Person i I paaftë për punë | 5000 |
| 12 | Shqiponjë Myftaraj | Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur | 5000 |
| 13 | Afërdita Mërtiri | Person i vetëm, jeton në Zagorie | 5000 |
| 14 | Rigels Ruli | Kryefamiljar ne nevojë | 5000 |
| 15 | Niko Karavidha | Person i paaftë për punë | 5000 |
| 16 | Gani Ruçi | Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur | 5000 |

Luten anëtarët e Këshillit Bashkiak të miratojnë ose jo dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin shkurt 2026.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika




Juristi
Kristaq Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. 619 prot

Libohovë më 04.04.2026

VENDIM

Nr. 14 Datë 31.03.2026

PËR MBAJTJEN HAPUR TË KOPSHTIT NEPRAVISHTË

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkronjës c të pikës I të udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023 “për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” ku citohet se: “Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njërive të vetëqeverisjes vendore”, kërkojmë nga Këshilli I Bashkisë miratimin e projekt-vendimit për të mbajtur hapur kopshtin Nepravishtë,

VENDOSI:

I.Kopshti Nepravishtë të qëndroj i hapur në shërbim të fëmijëve të fshatit Nepravishtë.

II.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Arsimit-Kulturës.

III.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratuar me 14 (katërbëdhjetë) vota

Vota Pro : 14 (katërbëdhjetë) vota

Vota Kundër : asnjë

Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRI SË
BASHKIA LIBOHOVË

P/VENDIM

Nr. ___ datë __. __. 2026

PËR MBAJTJEN HAPUR TË KOPSHTIT NEPRAVISHTË

Lënda : Relacion për mbajtjen hapur të kopshtit Nepravishtë.

I nderuar kryetar! Të nderuar këshilltarë dhe pjesëmarrës!

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkronjës c të pikës I të udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023 “për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” ku citohet se: “Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njësive të vetëqeverisjes vendore”, kërkojmë nga Këshilli I Bashkisë miratimin e projekt-vendimit për të mbajtur hapur kopshtin Nepravishtë,

VENDOSI:

1. Kopshti Nepravishtë të qëndroj I hapur në shërbim të fëmijëve të fshatit Nepravishtë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Arsim-Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SPECIALISTI

Arjan Çano

JURISTI

Kristaq Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. 479 Prot.

Libohovë, më 10.03 2026

Drejtuar : Këshillit Bashkiak

Lënda : Relacion për mbajtjen hapur të kopshtit Nepravishtë.

RELACION

I nderuar kryetar! Të nderuar këshilltarë dhe pjesëmarrës!

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", shkronjës c të pikës I të udhëzimit nr.14, datë 10.07.2023 "për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar" ku citohet se: "Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njësisë të vetëqeverisjes vendore", kërkojmë nga Këshilli I Bashkisë miratimin e projekt-vendimit për të mbajtur hapur kopshtin Nepravishtë.

Kopshti Nepravishtë ka aktualisht 6 fëmijë që frekuentojnë, duke u nisur nga baza ligjore dhe distanca (8.9 kl) e fshatit Neptavishtë nga kopshti nr.1, ku është i pamundur transferimi i fëmijëve nga kopshti Nepravishtë në kopshtin nr.1 Libohovë, kërkojmë që gjendur në këto kushte, Kopshti Nepravishtë të qëndrojë i hapur.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

Specialisti i Arsimit dhe Kulturës

Arjan Çano



REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 620 prot

Libohovë më 02.04.2026

VENDIM

Nr. 15 Datë 31.03.2026

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË KËSHILLIT
BASHKIAK LIBOHOVË PËR VITIN 2025

Baza ligjore: Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 7, neni 16, 18, 54, Rregullore e Organizimit dhe Fuksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullore së Marrëdhënies me Publikun me Mediat dhe Konsultimeve Publike, Rregullores së Strukturave Komunitare, Këshilli bashkiak Libohovë, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2026 pasi u njoh me raportin e performancës së këshillit bashkiak për vitin 2025, relatuar nga kryetari i këshillit:

VENDOSI

- I. Miratimin e Raportit të Performancës së Këshillit Bashkiak për vitin 2025.
- II. Për zbardhien e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak Libohovë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratuar me 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Pro : 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

Raporti i veprimtarisë për veprimtarinë e Këshillit Bashkiak për vitin 2025 dhe transparencës në procesin e vendimarrjes.

I nderuar Kryetar!

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak igji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 7, neni 16, 18, 54, Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullore së Marrëdhënies me Publikun me Mediat dhe Konsultimeve Publike, Rregullores së Strukturave Komunitare, Këshilli bashkiak Libohovë, gjatë vitit 2025 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit.

Këshilli bashkiak si organ përfaqësues dhe vendimarrës i qeverisjes bashkiake i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me ekonomi, eficientë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike dhe natyrore, duke punuar në parimet e interesit publik, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Këshilli bashkiak gjatë vitit 2025 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i përkasin shërbimit ndaj qytetarëve, zhvillimit të qytetit, mbështetjes dhe promovimit të turizmit, në ndihmën ekonomike dhe vendime ekonomike që kanë të bëjnë me :


1.-Zbatimin e buxhetit për vitin 2025, projektet e propzuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet.

2.-Ka marrë çdo muaj vendim për dhënien e ndihmës ekonomike financiare për familjet jo vetëm nga fondi i kushtëzuar, por edhe nga fondi i vet bashkisë.

Krahas këtyre vendimeve janë miratuar vendime për:

- Buxheti i vitit 2025 dhe projektbuxheti 2025 - 2027
- Vlen për për t'u përmendur miratimi projekt akteve që kanë të bëjnë me mbështetjen për emergjencat e ndodhura si pasojë e rënies së zjarrit. (por është kërkuar në vazhdimësi sigurimi i banesave nga qytetarët)
- Janë miratuar sipërfaqe kullimore dhe bujqësore për t'u dhënë me qira.
- Dhënje tituj „Qytetar Nderi“

- Buxheti i vitit 2025 dhe projekt buxhetin e vitit afatmesëm 2025 – 2027, zbatimin e buxhetit për vitin 2024.
- Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore.
- Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026.
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkes – ankesave të komunitetit.



Për periudhën Janar – Dhjetor 2025 Këshilli Bashkiak ka zhvilluar 1 (një) mbledhje jashtë radhë dhe 12 (dymbëdhjetë) mbledhje të planifikuara, gjithësejt 13 (trëmbëdhjetë) mbledhje dhe janë marrë gjithësejt 79 (shtatëdhjetë e nëntë) vendime .Vendime me karakter normativ dhe vendime me karakter individual.

Vendimet me karakter normativ kanë pasur të bëj me buxhetin dhe zbatimin e tij, përmirësimin e shërbimeve detajimin dhe shpërndarjen e buxhetit etj.

Vendimet me karakter individual kanë të bëj me dhënie e ndihmës ekonomike, dhënie tituj nderi , dhënie bursa etj.

- Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Libohovë kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave.
- Për të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Libohovë për vitin 2025, institucioni i prefektit të Qarkut Gjirokastrë për vendimet e Këshillit Bashkiak Libohovë për vitin 2025, është shprehur pozitivisht për 78 (shtatëdhjetë e tetë)mbi ligjshmërinë e tyre.
- Nga sa thamë më lartë, këto vendime të këshillit flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë pë t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve të komunitetit të bashkisë Libohovë;

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në vendime me karakter :

- 1.Financiar.
- 2.Social.
- 3.Infrastrukturë dhe strehim.
- 4.Probleme urbane dhe asete publike.
- 5.Emergjenca civile.
- 6.Për arsimin dhe kulturën.
- 7.Të ndryshme

Këshilli Bashkiak Libohovë gjatë vitit 2025 ka qenë mjaft aktiv duke zhvilluar mbledhjet e radhës, mbledhje jashtë radhe sipas tabelës së mëposhtme.

| NR | Muaji | Nr. I mbledhjeve | Mbledhje të rradhës | Mbledhje jashtë rradhe |
|----|-------|------------------|---------------------|------------------------|
| 1 | Janar | 1 | 1 | |



| | | | | |
|----|---------|---|---|---|
| 2 | Shkurt | 1 | 1 | |
| 3 | Mars | 1 | 1 | |
| 4 | Prill | 1 | 1 | |
| 5 | Maj | 1 | 1 | |
| 6 | Qershor | 1 | 1 | |
| 7 | Korik | 1 | 1 | |
| 8 | Gusht | 1 | 1 | |
| 9 | Shtator | 1 | 1 | |
| 10 | Tetor | 1 | 1 | |
| 11 | Nëntor | 1 | 1 | |
| 12 | Dhjetor | 2 | 1 | 1 |
| | | | | |

| Nr. | Periudha | Nr. I mbledhjeve | Mbledhje të rradhës | Mbledhje jashtë rradhe |
|-----|-----------------|------------------|---------------------|------------------------|
| 1 | 6 mujori i parë | 6 | 6 | |
| 2 | 6 mujori i dytë | 7 | 6 | 1 |
| 3 | Totali 12 mujor | 13 | 12 | 1 |

Këshilltarët që kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak.

| Nr. | Emër Mbiemër | Mbledhje të zhvilluara të Këshillit Bashkiak | Nr. I pjesmarrjes së këshilltarëve në mbledhje |
|-----|-------------------|--|--|
| 1 | Asim Banushaj | 13 | 13 |
| 2 | Behare Shehu | 13 | 12 |
| 3 | Kujtim Mushi | 13 | 12 |
| 4 | Elisabeta Kokoshi | 13 | 12 |
| 5 | Arjana Çomo | 13 | 12 |

| | | | |
|----|---------------------|----|----|
| 6 | Reshat Tosuni | 13 | 13 |
| 7 | Morena Myslimi | 13 | 13 |
| 8 | Violeta Ruçi | 13 | 13 |
| 9 | Krenar Kulla | 13 | 13 |
| 10 | Roland Kazma | 13 | 13 |
| 11 | Albion Bilibashi | 13 | 12 |
| 12 | Xhemile Myslimi | 13 | 10 |
| 13 | Emin Beqari | 13 | 13 |
| 14 | Altin Çomo | 13 | 12 |
| 15 | Fatbardha Karavidha | 13 | 12 |

- Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qenë aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu edhe në procesin e vendimarrjes në mbledhjet plenare fizike në sallën e mbledhjeve të këshillit Bashkiak Libohovë.
- Raporti vjetor për vitin 2025 të zbatimit të buxhetit të Këshillit Bashkiak, buxhet është miratuar vetëm për vitin 2025 për pagat dhe shpërblimet, shpenzime të tjera s'ka.
- Raporti vjetor i ankesave dhe kërkesave nga qytetarët për vitin 2025 në Këshillin Bashkiak janë regjistruar gjithësejt një ankesë dhe 20 (njëzetë) kërkesa, ku u është dhënë zgjidhje nga ana e Këshillit Bashkiak.
- Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendimet të sjella nga administrata e Bashkisë Libohovë.
- Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 146/2014, "Për konsultimin Publik" gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli ka zhvilluar dëgjesa publike në njësitë administrative Qëndër Libohovë, Zagorie dhe Libohovë, me shtresa në nevojë, bizneset dhe qytetarët.
- Përsa i përket miratimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, të buxhetit të bashkisë Libohovë për vitin 2026 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Libohovë për vitet 2026 – 2028, këshilli ka marrë pjesë në seancat dëgjimore së bashku me administratën e bashkisë.
- Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketën fiskale, tjetërsimin dhe dhënie me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj. Me qëllim pjesmarrjen aktive në vendimarrje të komunitetit, ku çdo këshilltar për aktet normative, për të cilat do të diskutohet në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohen apo të shqyrtohen.
- Në çdo mbledhje të këshillit nga ana e këshilltarëve është ngritur zëri për problematika që shqetësojnë qytetarët të cilat i janë paraqitur ekzekutivit për zgjidhje.
- Në mbledhjet e rradhës të Këshillit Bashkiak janë marrë në analizë sipas planit të miratuar puna e drejtorive në shërbim të qytetarëve.



- Është pasuruar faqia online e këshillit sipas kartelave rreth Këshillit Bashkiak
- Për sa më sipër ju falenderojmë secilin për kontributin e dhënë dhe ju ftojmë të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja për përmirësimin e punës së Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ Datë 31.03.2026

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË
PËR VITIN 2025

Baza ligjore: Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 7, neni 16, 18, 54, Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullore së Marrëdhënies me Publikun me Mediat dhe Konsultimeve Publike, Rregullores së Strukturave Komunitare, Këshilli bashkiak Libohovë, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2026 pasi u njoh me raportin e performancë së këshillit bashkiak për vitin 2025, relatuar nga kryetari i këshillit:

VENDOSI

- I. Miratimin e Raportit të Performancës së Këshillit Bashkiak për vitin 2025.
- II. Për zbardhjen e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak Libohovë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 621 prot

Libohovë më 02.04.2026

VENDIM

Nr. 16 Date 31.03.2026

PËR

MIRATIM KËRKESE PËR MIRATIM MARRËVESHJE TIP

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjes vendore", shkresës nr. 340/1 prot, date 19.03.2026 të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, miratim akt-marrëveshje me objekt: "Për lidhje Akt - Marrëveshje me Njësitë e Qeverisjes Vendore", pas diskutimit të kërkesës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Keshilli:

VENDOSI

I. Miratimin e kësaj marrëveshje tip me objekt: "Për lidhje Akt - Marrëveshje me Njësitë e Qeverisjes Vendore"

II. Për zbatimin e këtij vendimi nga kohe Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe Kryetari i Bashkisë Libohovë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

SEKRETARI I KËSHILLIT
Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Pro : 14 (katërbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenin : asnjë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. ____ prot

Libohovë më __.03.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. Date 31.03.2026

**PËR
MIRATIM KËRKESË PËR MIRATIM MARRËVESHJE TIP**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015”Për vetqeverisjes vendore”,shkresës nr. 340/1 prot, date 19.03.2026 të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë , miratim akt-marrëveshje me objekt: “Për lidhje Akt - Marrëveshje me Njësitë e Qeverisjes Vendore “,pas diskutimit të kërkesës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë,Keshilli:

VENDOSI

I. Miratimin e kësaj marrëveshje tip me objekt: “Për lidhje Akt - Marrëveshje me Njësitë e Qeverisjes Vendore “

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe Kryetari i Bashkisë Libohovë.

III.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

JURISTI

Kristaq Ciko



KRYETARI

Leonard Hido



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI JURIDIK

Nr. ____ Prot.

Libohovë, më _____.2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E AKT MARRËVESHJES ME KËSHILLIN E QARKUT GJIROKASTËR

KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË

I nderuar Kryetar i Këshillit !

Të nderuar këshilltarë dhe pjesmarrës në këtë mbledhje !

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.1, shkronja “a”, si dhe pika 1.6, shkronja “a”, paraqesim këtë relacion, i cili ka për qëllim të shtjellojë shkurtimisht arsyet pse duhet të miratohet Projekt Vendimi që i përket aktmarrëveshjes me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.

Referuar sa u tha më sipër, duke marrë në konsideratë bashkëpunimin ndërinstitucional që duhet të ekzistojë mes Këshillit të Qarkut dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për të bërë të mundur kryerjen me efektivitet të funksioneve, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe Këshilli Bashkiak Libohovë, nëpërmjet kësaj aktmarrëveshjeje synojnë, siç konkretisht përcaktohet në nenin 1 të aktmarrëveshjes: “të delegojnë funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në fushën e shërbimeve sociale, në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me qëllim realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 për Këshillin e Qarkut Gjirokastrë”.

Gjithashtu, bazuar në nenin 3 të aktmarrëveshjes, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, përcaktohet se “Këshilli i Qarkut merr përsipër realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 që kanë lidhje me funksionet e deleguara në nenin 1, Këshilli i Qarkut merr përsipër sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve funksion i kësaj aktmarrëveshjeje, Këshilli i Qarkut

do të informojë Bashkinë Libohovë rast pas rasti lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve, Bashkia Libohovë ushtron kompetencën dhe vendos për nivelin e kuotës së anëtarësisë të detyrueshme për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut, Këshilli i Qarkut dhe Bashkia Libohovë përmes kësaj aktmarrëveshjeje autorizojnë respektivisht Kretarin e Këshillit të Qarkut dhe Kryetarin e Bashkisë për lidhjen e aktmarrëveshjeve për projektet specifike rast pas rasti”. Sa i takon kohëzgjatjes dhe efektetve juridike, në nenin 2 përcaktohet se: “Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj aktmarrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj e do të zgjasin deri në 31.12.2026”, ndërkohë që në nenin 4, palët bien dakord se “kjo aktmarrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë me vullnetin e lirë të palëve”.

Bazuar në sa më lart, duke vlerësuar ndikimin që do të ketë kjo aktmarrëveshje në mbarëvajtjen e mëtejshme të punëve të Bashkisë Libohovë, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e P/Vendimit.

Bashkëngjitur po Ju paraqesim Projekt Vendimin.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin !

SPECIALIST I SEKTORIT JURIDIK

Kristaq Ciko



Nr 550 Prot
df 20.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 340/1 Prot.

Gjirokastrë, më 19.03.2026

Lënda: Kërkesë për miratimin e marrëveshjes tip.

BASHKISË LIBOHOVË

Bazuar në VKQ Nr.22, datë 09.12.2025, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka miratuar akt-marrëveshjen me objekt: "Për Lidhje Akt-Marreveshje me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore". Ju lutem në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak bëni të mundur vendosjen në rend të ditës miratimin e kësaj marrëveshje tip. Mbetemi në pritje të miratimit të saj nga Këshilli i Bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!

KRYETAR

Dino Selimi





REPUBLIKA E SHQIPERISË



KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 881/ Prot, datë 18/12/2025



KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 550/ Prot, datë 31/08/2026

AKTMARRËVESHJE

Sot më datë 18.12.2025 duke u mbështetur në vullnetin e lirë të palëve,

1. Këshilli i Qarkut Gjirokastrer i përfaqësuar nga Kryetari Z.Dino Selmi.
2. Këshilli Bashkiak Libohovë përfaqësuar nga Kryetari Z/Znj. Asim Banushaj

Mbeshtetur ne Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", përkatësisht Neni 31/2 dhe 22/3 i tij, kane rënë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.



NENI 1

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti i kësaj akt marrëveshje është delegimi i funksioneve të mëposhtme:

- në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- në fushën e shërbimeve sociale
- në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
- në fushën e mbrojtjes së mjedisit

me qëllim realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 për Këshillin e Qarkut Gjirokastrer.

NENI 2

KOHËZGJATJA DHE EFEKTET JURIDIKE



Palët bien dakort se efektet juridike të kësaj akt marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj e do të zgjasin deri në 31.12.2026.

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

3.1 Këshilli i Qarkut merr përsipër realizimin e objektivave të vendosura në buxhetin e vitit 2026 që kanë lidhje direkte me funksionet e deleguara në nenin 1.

Këshilli i Qarkut merr përsipër sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve funksion i kësaj akt -marrëveshjeje

3.2 Këshilli i Qarkut do të informojë Bashkinë Libohovë rast pas rasti lidhur me ecurinë e raalizimit të projekteve.

3.3 Bashkia Libohovë ushtron kompetencën dhe vendos për nivelin e kuotës së anëtarësisë të detyrueshme për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut.

3.4 Këshilli i Qarkut dhe Bashkia Libohovë përmes kësaj akt-marrëveshjeje autorizojnë respektivisht Kryetarin e Këshillit të Qarkut dhe Kryetarin e Bashkisë për lidhjen e akt-marrëveshjeve për projektet specifike rast pas rasti.

NENI 4

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Kjo akt-marrëveshje mund të përmirsohet në çdo kohë me vullnetin e lirë të palëve.

Kjo akt-marrëveshje miratohet nga palët dhe nënshkruhet me pëlqimin e plotë të tyre në tre (3) kopje origjinale.

| Këshilli i Qarkut Gjirokastrër | Këshilli Bashkiak Libohovë |
|---|--|
| Dino Selimi | |
| Kryetar | Kryetar |
|  |  |

